



SBASHK Arsimimi sot

Qershor, 2026

Gazeta elektronike

Edhe këtë verë qindra anëtarë të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar



“Bazuar në mjetet e akumuluar në fondin për pushim dhe rekreacion, këtë vit dërgohen 450 pushues në Kompleksin Turistik “Bonita” ... (faqe 4)

SBASHK-u mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar ‘Istanbul EdUnion Forum 2026’



Në Forumin Ndërkombëtar ‘Istanbul EdUnion Forum 2026’, që ishte mbajtur në Stamboll nga 16 deri më 18 qershor 2026, kishte marrë pjesë edhe... (faqe 5)

Përfundoi edhe një vit shkollor



Për nëntë muaj me radhë në qindra institucione shkollore, koleget e kolegët zhvilluan shumë beteja për ... (faqe 2)

Krasniqi: Malisheva u dëmtua shumë nga aëtarësimi përmes e-Kosovës, po e rikthejmë anëtarësinë



Mësimdhënësit e Malishevës përballen me probleme të ndryshme si në mbarë vendin si kushte të dobëta të... (faqe 3)

Zgjedhjet Sindikale në Dragash – Kryetar u rizgjedh Vloran Krasniqi



Në Dragash u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjedhën kryetari... (faqe 6)



Editorial

Përfundoi edhe një vit shkollor



Përfundoi edhe një vit shkollor. Për nëntë muaj me radhë në qindra institucione shkollore, koleget e kolegët zhvilluan shumë beteja për dije të reja. Ata i janë gëzuar sukseseve dhe kanë ndarë gëzimet për notat e mira me prindërit. Ky vit shkollor përfundoi e Kosova shkoi nga një palë në një palë tjetër të zgjedhjeve dhe mungoi dialogu për kërkesat e anëtarësisë sepse munguan institucionet. Kjo gjendje ka shqetësuar punëtorët e arsimit, por ata kanë vazhduar misionin e tyre të shenjtë për edukimin e brezave me shpresën se do të dalin institucione me njerëz që respektojnë dialogun dhe që e duan arsimin e jo me ata që nuk duan dialog dhe veprojnë e angazhohen kundër zërit sindikal dhe nuk pranojnë

të realizohet as edhe një kërkesë të anëtarësisë. Arsimit, që nga çerdhet e deri në universite, i duhet një ministër a ministre, që e do dhe e njeh arsimin dhe që nuk është tekanjor e i mbushur me inat. I duhet një ministër që e do dialogun dhe angazhohet bashkë me SBASHK-un, Këshillin e Prindërve, me DKA-të dhe palët tjera për të mirën e arsimit të vendit tonë. Me inat e duke u mbyllur në vetëvete nuk arrihet të realizohen objektivat. Këtë duhet ta dinë ata që gjenden në krye të institucioneve sepse në të kundërtën, në vend të dialogut e marrëveshjeve do të kemi përplasje, protesta e greva, të cilat SBASHK-u nuk i do, por si gjithmonë, edhe në të ardhmen, do të veprojnë sipas zërit të anëtarësisë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Krasniqi: Malisheva u dëmtua shumë nga aëtarësimi përmes e-Kosovës, po e rikthejmë anëtarësinë



Mësimdhënësit e Malishevës përballen me probleme të ndryshme si në mbarë vendin si kushte të dobëta të punës, digjitalizim i pamjaftueshëm i shkollave e mbingarkesë në punë.

Por, një ndër problemet me të cilin është përballur SBASHK në përgjithësi e ku Malisheva është dëmtuar shumë, është q' anëtarësimi i

anëtarësisë së SBASHK-ut nga ana e Qeverisë dhe obligimi i anëtarësimi përmes platformës e-Kosova.

Sipas kryetarit të sapozgjedhur të NSKAP-it të Malishevës, Naser Krasniqi, ky ndryshim SBASHK-un e k dëmtuar mjaft pasi për rikthimin e anëtarësisë ka pas edhe probleme teknike me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit, dhe kjo ka shkaktuar probleme.

Gjatë intervistës me kryetarin e Nivelit Sindikal Komunal të Arimit Parauniversitar në Malishevë (NSKAP), Naser Krasniqi, mund të lexoni edhe për probleme tjera me të cilat përballen sistemi i arsimit si rënia e numrit të nxënësve etj.

SBASHK: Inderuar profesor Krasniqi, tashmë jeni zgjedhur kryetar i NSKAP-it të Malishevës, cilat janë synimet tuaja për këtë pozitë?

Krasniqi: Marrja e bësimit për të udhëhequr NSKAP-in në komunën e Malishevës është një përgjegjësi e madhe dhe një obligim për të ju shërbyer të gjithë anëtarëve të shoqatave sindikale, mendoj në keto synime:

- Të mbrojmë me përkushtim të drejtat dhe interesat e të gjithë punëtorëve të arsimit.
- Të forcojmë bashkpunimin me të gjitha shoqatat sindikale të shkollave në komunën tonë.
- Të jemi zëri i mësimdhënësvë dhe të angazhohemi për përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së tyre.
- Të promovojmë unitet, transparencë dhe dialog konstruktiv brenda organizatës tonë.

SBASHK: Sindikata e Malishevës numëron një numër relativisht të lartë të anëtarëve, sa ka kërkesa për anëtarësime të reja dhe cilat janë synimet tuaja në këtë drejtim?

Krasniqi: NSKAP-i në Malishevë ka pasur 917 anëtar, por duke i parë problemet e q' antarësisë pa vullnetin tonë nga Qeveria e tanishme, momentalisht kemi 605 anëtarë, por ky numër veç ka filluar të rritet, falë bashkëpunimit dhe

bisedave me kryetarët e shoqatave sindikale nëpër shkolla. SBASHK-u ka ndihmuar punëtorët e arsimit më trajnime të ndryshme të cilat janë të akredituara nga MASH, dhe këto trajnime janë bazë për rilicencimin e mësimdhënësvë të niveleve të ndryshme. Dhe synimi jonë është që të kontribuojmë në rritjen e antarësisë.

SBASHK: Cilat janë ankesat /problemet e mësimdhënësvë të Malishevës të cilat kërkojnë adresim nga ju?

Krasniqi: Edhe në komunën tonë janë pothuaj problemet e njëjta si çdo komunë tjetër sepse nëpër disa shkolla ka filluar të bie numri i nxënësve që është preokupim i të gjithë neve që jemi duke punuar me ta. Problem që e shoh unë është normativi i mësimdhënësvë dhe do të kërkohej një organizim i përbashket për të zgjidhur këtë dukuri që po na paraqitet në vendin tonë.

SBASHK: SBASHK organizon vazhdimisht trajnime për mësimdhënësit anëtar të cilat atyre u ndihmojnë për licencim dhe rilicencim, cilat janë kërkesat e tyre në këtë drejtim?

Krasniqi: Në komunën tonë kemi realizuar shumë trajnime që janë organizuar nga SBASHK-u, ku ato trajtime po ju ndihmojnë që punëtorët e arsimit të kenë mundësi që të pajisen me çertifikata që janë të domosdoshme për periudhën e licencimit dhe të rilicencimit të tyre. Është kërkesë që në fillim të vitit shkollor të mbahen trajnime shtesë për mësimdhënësit që janë pa trajnime dhe kanë bërë kërkesë edhe te ish kryetari, por nuk arritën me u realizuar si pasojë e pushimit në këtë vit shkollor. Prandaj, unë do të bëjë kërkesë për t'i realizuar këto trajnime në fillim të vitit shkollor 2026/2027.

SBASHK: Cilat janë synimet e juaja për zhvillimin e sindikatës në komunën tuaj?

Krasniqi: Synimet dhe pritshmëritë tona janë në rritjen e anëtarësisë në shoqatat sindikale dhe formimin e shoqatave që ende nuk janë të regjistruara pasi ato pa dëshirën e tyre u ç' regjistruan.

Bashkpunimi im do të jetë gjithmonë në dobi dhe interes të anëtarësisë së SBASHK-ut, këtë do ta arrij me bashkpunim reciprok me të gjitha strukturat organizative të sindikatës në nivelin komunal të Malishevës dhe me kryesinë qëndrore të SBASHK-ut, në nivelin qëndror në Prishtinë. Faleminderit për këto pyetje që kanë interesin dhe organizimin e një sindikate më të sukseshme për të ndihmuar dhe krijuar kushte më të mira bashkë e në SBASHK.

Ju faleminderit nga unë kryetari i NSKAP-it në Malishevë, Naser Krasniqi.

Gjatë muajit

Edhe këtë verë qindra anëtarë të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar



Grupi i parë prej rreth 140 anëtarëve kishte shkuar të dielën e 21 qershorit, derisa këtë udhëtim tradicional e përmbyll grupi i tretë i cili udhëton me 1 korrik 2026 e që do t'i ketë mbi 200 pushues. Kryetari i komisionit për përgatitjen e këtij aktiviteti, Ymer Ymeri ka treguar se pushuesit kanë shprehur përshtypje të shkëlqyera për ambientet e Kompleksit Hotelier "Bonita" dhe për organizimin e këtij aktiviteti.



SBASHK-u edhe këtë vit ka vazhduar me aktivitetin tradicional të dërgimit në bregdetin shqiptar të një numri të konsideruar të anëtareve e anëtarëve nga e tërë Kosova. "Bazuar në mjetet e akumuluar në fondin për pushim dhe rekreacion, këtë vit dërgohen 450 pushues në Kompleksin Turistik "Bonita".



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili po ashtu ka qëndruar me mësimdhënës në bregdetin shqiptar dhe ka bashkëbiseduar me ta rreth qështjeve të cilat i preokupojnë por edhe shumë tema tjera të arsimit, e ka përgëzuar Komisionin përgaditor të këtij aktiviteti duke u shprehur i sigurt se ky aktivitet do të ketë rrjedhë të mbarë dhe se pushuesit me sjelljet e kulturuar do ta ruajnë figurën e punëtorit arsimor.



Më 26 qershor ishte nisur grupi i dytë i pushuesve prej mbi 130 anëtarëve të SBASHK-ut, të cilët do të qëndrojnë në bregdetin e Durrësit deri më 1 korrik 2026 në pushimin e organizuar nga SBASHK. Ky pushim për mësimdhënës e kontribuues të mëdhenj në arsimin shqip të Kosovës i cili tashmë është bërë tradicional, organizohet në shenjë falënderimi për punën dhe përkushtimin e tyre në edukimin e brezave të tërë.



SBASHK-u mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar ‘Istanbul EdUnion Forum 2026’



Në Forumin Ndërkombëtar ‘Istanbul EdUnion Forum 2026’, që ishte mbajtur në Stamboll nga 16 deri më 18 qershor 2026, kishte marrë pjesë edhe delegacioni i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK), i përbërë nga Ymer Ymeri, Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut, dhe Vjollca Shala, Nënkyetare e SBASHK-ut. Forumi, i cili këtë vit ishte zhvilluar me temën “Arsimi dhe Puna në Epokën e Pasigurisë Globale: Probleme të Përbashkëta, Zgjidhje të Përbashkëta”, dhe kishte mbledhur në Stamboll 132 drejtues sindikalë dhe përfaqësues të organizatave arsimore nga 55 vende të botës. Në këtë ngjarje kishin marrë pjesë sindikata të arsimit nga Evropa, Azia, Afrika dhe Amerika e Jugut, si dhe organizata të rëndësishme ndërkombëtare e rajonale të arsimit.



Gjatë punimeve të forumit ishin trajtuar tema me rëndësi të veçantë për të ardhmen e arsimit dhe të punës, si ndikimi i krizave globale në sistemet arsimore, migrimi, transformimi digjital, inteligjenca artificiale, mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, barazia gjinore, arsimi gjithëpërfshirës dhe roli i organizatave sindikale në përballimin e sfidave të kohës. Një nga temat që lidhet drejtpërdrejt me angazhimet dhe prioritetet e SBASHK-ut ishte Punëtorja “Revolucioni Digjital dhe Inteligjenca Artificiale: Fryma e Arsimit dhe e Ardhmja e Punës”, ku ishte diskutuar ndikimi i inteligjencës artificiale në profesionin e mësuesit, transformimi i proceseve arsimore, të drejtat mbi të dhënat, menaxhimi algoritmik dhe mbrojtja e të drejtave sindikale

në mjedisin digjital. Në këtë grup pune ishte përfshirë edhe Kosova, duke i dhënë mundësi delegacionit të SBASHK-ut të paraqesë përvojat dhe qëndrimet e arsimit kosovar lidhur me këto zhvillime bashkëkohore.



Gjatë qëndrimit në Stamboll, delegacioni i SBASHK-ut kishte zhvilluar takime të veçanta edhe me Kryetarin e Sindikatës së Arsimit të Turqisë, Ali Yalçın. Me këtë rast, ai kishte shprehur mirënjohje për pjesëmarrjen e SBASHK-ut në forum dhe kishte ritheksuar marrëdhëniet e mira, bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe miqësinë e ndërtuar ndër vite ndërmjet dy organizatave sindikale. Ai po ashtu kishte vlerësuar raportet shumë të mira që ekzistojnë ndërmjet Kosovës dhe Turqisë, duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe të veprimtimit sindikal. Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë forum ndërkombëtar paraqet një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave me organizata sindikale nga mbarë bota, për prezantimin e sfidave dhe të arritjeve të arsimit në Kosovë, si dhe për forcimin e solidaritetit ndërkombëtar në mbrojtje të të drejtave të punëtorëve të arsimit.

Delegacioni i SBASHK-ut ka vazhduar të kontribuojë në diskutimet dhe aktivitetet e forumit deri në përmbylljen e tij, kur është miratuar edhe Deklarata Përfundimtare e Istanbul EdUnion Forum 2026.

SBASHK në Konferencën e 114-të Ndërkombëtare të Punës në Gjenevë



Nga data 1 deri më 12 qershor 2026, delegacioni i SBASHK-ut, i përbërë nga nënkryetarja znj. Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Ymer Ymeri, kishin marrë pjesë në punimet e Sesionit të 114-të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Gjenevë, Zvicër. Delegacioni ynë kishte përfaqësuar zërin e arsimit parauniversitar dhe universitar të Kosovës në kuadër të organizatës botërore të arsimit, Education International.



Në këtë ngjarje madhore botërore, përfaqësues të Qeverive, Punëdhënësve dhe Punëtorëve nga 187 Shtetet Anëtare të ILO-s ishin mbledhur për të diskutuar dhe vendosur mbi sfidat kryesore të botës së punës. Ndër temat kryesore ishin trajtuar:

Puna e denjë në ekonominë e platformave digjitale.

Agjenda transformuese për barazinë gjinore në punë.

Dialogu social dhe tripartizmi si shtylla të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.



Punimet ishin zhvilluar paralelisht në seancat plenare në Palais des Nations dhe në komitetet teknike të shpërndara në tri lokacione kryesore: CICG, Palais des Nations dhe selia qendrore e ILO-s. Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këto nivele të larta ndërkombëtare dëshmon përkushtimin tonë për të ndjekur dhe zbatuar standardet më të avancuara globale në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit, si dhe për të fuqizuar dialogun social me institucionet tona vendore.

ZGJEDHJET NË SBASHK

Edhe gjatë muajit qershor SBASHK ka vazhduar me zgjedhjet e Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit (NSKAP)

Zgjedhjet Sindikale në Dragash – Kryetar u rizgjodh Vloran Krasniqi



Gjatë qershorit zgjedhjet Sindikale u mbajtën në Dragash, ku kryetar u rizgjodh Vloran Krasniqi. Më 12 qershor 2026 në Dragash u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, kryesia e re e NSKAP-it të Dragashit, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Gjatë procesit zgjedhor në Dragash ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri.

Procesi zgjedhor në Dragash u zhvillua në mënyrë të



regullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i NSKAP-it të Dragashit u rizgjodh Vloran Krasniqi. Kuvendi i NSKAP-it të Dragashit, i propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut si dhe propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.



Kurse, paraprakisht zgjedhjet Sindikale ishin mbajtur edhe në Lipjan

Zgjedhjet Sindikale në Lipjan – Kryetar u zgjodh Artan Buja, ndërsa nënkryetare Luljeta Rudari

Më 10 qershor 2026 në Lipjan u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Lipjanit, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Lipjan ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri.

Procesi zgjedhor në Lipjan u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar

i NSKAP-it të Lipjanit u zgjodh Artan Buja, ndërsa nënkryetare Luljeta Rudari.



Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut

TRAJNIME

SBASHK e përmbylli vitin shkollor me dhjetëra grupe të trajnimeve të organizuara për anëtarësinë anë e kënd Kosovës



SBASHK gjatë gjithë vitit kalendarik por veçanërisht gjatë vitit shkollor organizoi dhjetëra grupe të trajnimit për mësime të mësimdhënësve në mbarë Kosovën, të cilat i përmbylli suksesshëm në muajin qershor, para pushimeve verore. Shumë grupe të trajnimit u mbajtën gjatë muajit maj, e të cilat përfunduan në qershor me organizimin e testeve në grupet e programit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Të shtunën e 20 qershorit SBASHK organizoi testin për një grup të mësime të mësimdhënësve në komunën e Mamushës, të cilët e kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, nën

udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Fahri Morina. Gjatë testimit, për t'u kujdesur për mbarëvajtjen e trajnimit dhe testimit të mësime të mësimdhënësve, trajnimin e përcolli nga afër edhe kryetarja e NSKAP-it për Mamushë, Indira Haliti.



Ndërkohë, një javë më parë SBASHK kishte mbajtur testet edhe për pesë grupe të trajnimit në Prizren e Rahovec.




Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në Prizren testet ishin mbajtur për dy grupe të mësimeve të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” në modulin e parë, e të cilat ishin udhëhequr nga trajnerët, Albert Samadraxha, respektivisht Naser Kastrati. Po ashtu ishte mbajtur testi edhe për grupin e tretë të mësimeve të cilët e kishin ndjekur trajnimin po në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” moduli i dytë, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Arben Zymeri.



Gjatë testimit në Prizren kishte qendruar edhe kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Reshit Kushaj dhe nënkryetaria Hyrije Hoti të cilët ishin kujdes për mbarevajtjen e testimit dhe kushtet e punës për mësime. Gjatë testimit në Prizren po ashtu kishte qendruar për vëzhgim të trajnimeve edhe Zyrtari i Lartë për Zhvillim Profesional të Mësimeve dhe Licencim të Personelit Arsimor në MASH, Luan Sahitaj.



Ndërkohë, dy grupe të trajnimit kishin përfunduar në të njëjtën ditë edhe në Rahovec në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” moduli i parë, e të cilat ishin udhëhequr nga trajnerja Albana Duraku.



Edhe në Rahovec ishte organizuar testi për mësime të cilët me sukses e kishin përfunduar këtë trajnim. Ndërsa, për t'u kujdesur për mbarevajtjen e testimit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Rahovec, Mehmet Kryeziu.



Për vëzhgimin e organizimit të testeve nga MASH, në Rahovec ishte edhe UD Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillim Profesional dhe Licencim të Personelit Arsimor, Osman Beka.



Ndërkohë, në Dragash ishte organizuar testi për një grup të mësimeve të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” moduli 2.



Trajniti “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Arton Ajeti, derisa për t'u kujdesur për mbarevajtjen e vijueshmërisë dhe kushteve të punës, mësuesit i vizitoi edhe kryetari i NSKAP-it për Dragash, Vloran Krasniqi, i cili u dëshiroi mësimeve punë të mbarë dhe suksese sa më të larta në zhvillimin profesional.




Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Kurse testi për një grup të mësimeve në fillim të muajit qershor ishte mbajtur edhe në Podujevë për mësime të cilët e kishin vijuar me sukses trajnimin po ashtu në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”. Trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri Muhamet Shabani dhe ishte mbajtur në shkollën Fan S. Noli.

Gjatë testimit, për të përcjellur mbarëvajtjen e procesit dhe për t’u kujdesur për kushtet e punës së mësimeve, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Podujevë, Fadil Halimi.

Ai u kishte dëshiruar mësimeve arritje sa më të larta dhe zhvillim sa më të lartë profesional.



Ndërsa, në Mitrovicë SBASHK kishte organizuar testet qysh në fillim të muajit qershor për dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, moduli 1 dhe moduli 2. Trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” moduli i parë ishte udhëhequr nga trajneri Kadri Hyseni dhe ishte mbajtur në shkollën “Musa Hoti”. Kurse trajnimi i programit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” moduli 2 ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Fevzi Selmani, dhe ishte mbajtur në shkollën “Hasan Prishtina” në Mitrovicë.



Gjatë testimit, për të përcjellur mbarëvajtjen e procesit dhe për t’u kujdesur për kushtet e punës së mësimeve, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli. Ai u kishte dëshiruar mësimeve arritje sa më të larta dhe zhvillim sa më të lartë profesional. SBASHK vazhdon me trajnime në të gjitha komunat e Kosovës për mësime anëtar të Sindikatës.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture